



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 4315 Prot

Maliq, më 06.9.2024

PROJEKT VENDIM

Nr. 7 datë 06/09/2024

“Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma (dh), Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” i kërkoj Këshillit të Bashkisë :

1. Detajim të fondit prej **586,927 lekë** për “Blerje lëndë druri për urat”
2. Fondi prej **586,927 lekë** të pakësohet nga “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme ndërtimore në mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me objekt “Rehabilitim objekte infrastrukture”.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Sektori i Emergjencave Civile në bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TORCI



RELACION

“Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile”

Fondi i Emergjencave Civile që ja u kemi sjellë për detajim rezulton i kursyer prej procedurave të prokurimit të realizuara nga ana jonë për transfertën e kushtëzuar të Emergjencave Civile..

1. Shpenzimi i miratuar nga ana Juaj për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi të tjera natyrore , përcaktuar në zërin “Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” – Kodi 91707AB
2. Në zonën e Gorës kemi disa ura të cilat duhet rehabilituar në këtë prag dimri .
3. Në këto ura lëvizin banorët edhe nxënësit dhe janë me konstruksion metalik e beton dhe kanë nevojë për zëvendësimin e pjesës së drurit .
4. Fondi i kursyer do të përdoret për blerje lëndë druri dhe punëtorja do te realizohet nga ana jonë me punonjësit e shërbimeve.

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

